

DIANA DJALOSHI

**VEÇORITË E NDËRTIMIT TË MODELEVE TË REJA
GJUHËSORE NË LIGJËRIMIN POLITIK**

Njësitë e reja gjuhësore në gjithë gjuhën kanë shkallëzime të caktuara shumë më tepër në nivelin leksikor se në nivelet e tjera, meqë në disa nivele formimet ose ndërtimet e reja mbeten të pandryshueshme, p.sh., në nivelin fonetik, pak më shumë, në atë morfologjik, e më të theksuara janë ato të nivelit leksikoro-fjalëformues.

Me zhvillimet e rëndësishme kulturoro-ekonomike e sidomos politike, për plotësimin e nevojave për emërtime, krijohen mundësi për modele të reja. Përveç kësaj, krahas modeleve të reja, ndryshon edhe aktivizimi shumë i madh i modeleve ekzistuese. Si p.sh. aktivizimi shumë i madh i fjalëve të përbëra, “togfjalëshave të qëndrueshëm”¹ për përballimin e nevojave të reja për aktivizimin e atyre të vjetra si dhe atyre të sotme, ku, sigurisht, modelet e reja të ndërtimeve janë po ato, sidomos për emërtimin e koncepteve abstrakte.

Fillimisht duhet vështruar aktivizimi me intensitet të lartë i modeleve gjuhësore ekzistuese, siç u përmend më sipër fjalët, kompozitat (*politikëbërje, politikëbërës, taksapagues, taksëmarrës*) ku aktivizohen, sidomos njësitë fjalë por në përbërje të vetë njësi si një lloj morfeme rrënjë: *bashkëfajtor, bashkëjetës, bashkëvuajtës, bashkëpronar, bashkëekzistencë* etj.

Së dyti futen togfjalëshat e qëndrueshëm, që përbëjnë pjesën më të madhe të njësi që përdoren për nevojat e reja të gjuhës (sigurisht ato janë njësi me ndërtim sintaksor) struktura të hapura, por semantikisht janë unike nga përmbajtja, sepse shënojnë një koncept të vetëm si në rastet: krim i organizuar, krim i rëndë etj.

Së treti, në nivelin e modeleve të reja, këto njësi sidomos në ligjërimin politik², ku përdoren rëndom, në parlament, në fushata elektorale, në fjalime politike etj., vendin e parë e zënë kompozitat si: *ramostan, salalbania, kanabistan, salisgrad* etj.

¹ A. Duro, *Togfjalëshat e qëndrueshëm terminologjikë në shqipen e sotme*, “Studime filologjike”, 1982, 2009.

² Xh. Lloshi, *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001.

Lidhur me grupin e parë ka studime të shumta, por edhe për të dytin e sidomos në fushën e terminologjisë dhe sidomos për kompozitat Leksikore nga: A. Kostallari³, J. Thomai⁴, A. Duro⁵, A. Xhuvani⁶ etj.)

Vendin e parë me interes studimi, lidhur me veçoritë e ndërtimeve të mësipërme, janë modelet e reja (grupi i tretë), të nivelit leksiko-fjalëformues. Nga vëzhgimet që kemi bërë, materiali i mbledhur dhe shqyrtuar, ne kemi vënë në fokus grupin e tretë, meqë kanë të bëjnë pikërisht me modelet e reja të ndërtimeve gjuhësore.

Tiparet e konceptit “efemerizëm” të shprehur nga fjala efemerizëm

Efemerizmat janë njësi të cilat lindin në kushte të caktuara politike dhe sociale dhe kanë kryesisht konotacion negativ dhe u përgjigjen dukurive politike të kohës së sotme. Ato janë fakte të ligjërit, kanë vlerë të përkohshme dhe janë formime të shtrembëruara gjuhësore, edhe pse ndjekim modele ekzistuese ndërtimi dhe në të shumtën e rasteve nuk nguliten në gjuhë. Vetë emërtimi “njësi efemere” i konceptuar në këtë punim, lidhet me “bimë efemere” apo “kafshë efemere”, të cilat kanë jetë të shkurtër. Shumë rrallë ndodh që efemerizmat të nguliten, si p.sh., fjalët *bllokmen* dhe *neobllokmen*, të cilat janë ngulitur tashmë në gjuhën e përditshme (sidomos në diskursin politik). Këto njësi nguliten sidomos për shkak të përdorimit të gjatë në kohë dhe të numrit të madh të përdoruesve. Kur ndodh ngulitja, fjalët, të cilat lindin si efemere nuk konsiderohen më të tilla. Këto fjalë (efemerizmat) kanë ngarkesë të madhe negative dhe kanë karakter tallës, ironizues dhe sarkastik, dhe si të tilla kanë vlera të veçanta karakterizuese. Sharjet dhe ironizimet të emërtuara me fjalë në format nga më të çuditshmet, janë pjesë sidomos e ligjërit politik.

Në ligjërimin aktual politik, efemerizmat përdoren sidomos kur një parti apo individ përshkruan veprimtarinë e një partie apo të një lideri partie kundërshtar apo edhe kur përshkruan lindjen e një dukurie të re ekonomike, shoqërore apo politike. Këto fjalë ndeshen kryesisht në gazeta, fjalime, në rrjetet sociale dhe në thjeshtëligjërim dhe kanë karakter situativ. Krijuesit e njësive efemere manipulojnë me aftësitë kombinuere të elementeve gjuhësore. Sidomos në vitet e fundit kemi krijime të shumta, të

³ A. Kostallari (1972). *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë.

⁴ J. Thomai, *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, SF, 1964/2.

⁵ A. Duro, *Terminologjia si sistem*, “Panteon”, Tiranë, 2001.

⁶ A. Xhuvani (1980), *Kompozitat*, “Vepra”, 1, Akademia e Shkencave, Tiranë.

pasqyruara në shtypin periodik të kohës si në gazetat: “Panorama”, “Dita”, “55” etj.

Fjalëformimi, në rastin e fjalëve efemere, është shumë interesant dhe ka forma hibride. Fjalët efemere janë të zbërthyeshme dhe të kuptueshme morfologjikisht si p.sh.: fjala *ramastan* zbërthehet në: *Rama* (E.R.) + *stan* (vend). Fjala “*Rampalla*” (e përdorur në rrjetet sociale të ndjekësve të PD) zbërthehet në: *Rama* (mbiemri i E. R.) + *palla* (fjalë vulgare sharëse), kjo fjalë e formuar në këtë mënyrë, i ngjan fonetikisht fjalës “*rrumpalla*” (fjalë që e ka thënë E. R. si edhe shumë pasues të P.S. për të karakterizuar figurën politike të S. B.).

Fjalët *bllokmen* dhe më vonë *neobllokmen* lindën për të përshkruar zonën e Bllokut (Bllok: zona e Bllokut, e cila ishte e mbyllur për shqiptarët) + *men* (fjalë e huaj). Fjala *bllokmen* emërton banorët e rinj të Bllokut që përfaqësojnë të vetëquajturën *elitën e re*, të pasur dhe me status të lartë shoqëror dhe politik.

Shumë formime efemere janë cenime të strukturës gjuhësore. Shembuj përbëjnë: *Bilalgate*, *Edvingate*, *sheeptar*, *shukriziu*, *kanabistan*, *ramastan*, *absurdistan*, *rameta*, *ramokraci*, *salalbania*, *saliala*, *saligrad*, *salisburg*, *berishemi*, *gangokraci* etj. Një formim interesant që tregon mendësi negative për shqiptarët, që sipas perceptimit të atyre që e kanë formuar, kanë karakter të nënshtresueshmë si delet, është edhe fjala “*sheeptar*”, që formohet nga “*sheep*” në anglisht + *dele* në shqip. Në këtë rast fjalëformimi është po ashtu i karakterit hibrid: formohet nga dy pjesë: *sheep* (*dele*) + *tar* (prapashtesë shqipe) që asociohet me fjalën *shqiptar*. Po kështu kohët e fundit në shtyp është përdorur fjala “*Thatmir*”. Vendosija e “*Tha*” mund të jetë përdorur për të ironizuar në lidhje me një hidrocentral që u *tha*, apo për t’a sharë (*thuthuq*) politikanin në fjalë, i cili quhet Fatmir. Njësitë efemere *Bilalgate*⁷, *Edvingate*⁸, janë njësi analoge me njësinë “*Watergate*”⁹, ndërsa togfjalëshi “*Skandali Bilalgate*”¹⁰ është analog me njësinë Skandali Watergate.

Në vitet e periudhës pluraliste, sharjet (*kloun*, *plehrë*, *pinok*, *Doktor rrumpalla*, *ramastan*) janë dëshmi e larmisë së madhe të mendësive në lidhje me denigrimin e kundërshtarit politik, si edhe në të njëjtën kohë tregojnë për një lloj *lirie* dhe *shumëllojshmërie* përdorimi të fjalëve në krahasim me periudhën moniste, ku sharjet pothuajse mungonin fare. Një

⁷ S. Berisha, Facebook 3 Korrik, 2016.

⁸ S. Berisha, Facebook 6 Korrik, 2016.

⁹ https://en.wikipedia.org/wiki/Watergate_scandal

¹⁰ S. Berisha, Facebook 3 Korrik, 2016.

tjetër tendencë e komunikimit politik me karakter sharës është që fjalët apo njësitë e tjera me karakter sharës apo denigrues janë të njëjta apo fonetikisht të ngjashme për të dyja palët kundërshtarë. Shembull përbëjnë fjalët: *Rrumpalla* dhe *Rampalla* (njëra fjalë ekzistuese me kuptim sharës) dhe fjala tjetër, efemerizëm, të cilat kanë një ngjashmëri shumë të madhe fonetike. Kjo mënyrë e denigrimit të kundërshtarit konsiderohet më efikase dhe ka një ndikim më të madh tek publiku. Kohët e fundit është sajuar njësia *Rameta*¹¹ (krijuar nga K. M.), që përdoret me shpoti për parashikimin e prishjes së koalicionit nga Rama dhe Meta (Ra Meta=i mundur nga E. Rama = për koalicionin e Reformës në Drejtësi) apo dhe për të përshkruar me humor koalicionin qeverisës.

Efemerizmëformimi (eferizmimi):

Efemerizmëformimi përcakton procesin e formimit të *efemerizmave* të ndërtuara me elemente të huaja dhe vendëse, me kombinime të tyre (me shkurtime, shtrembërime etj.), ku elementët përbërës janë të zbërthyeshme dhe kuptimisht të qarta, por që duhen të interpretohen. Shembujt e mëposhtëm pasqyrojnë disa nga mënyrat kryesore të formimit të efemerizmave:

*Naltgjatësia*¹²: *nalt* (ironi për pozicionin e Edi Ramës) + *gjatësia* (ironi me gjatësinë e tij) është formim sipas modelit *naltmadhnia*;

Kanabistan: *kanabis* (drogë) + *stan* (vend), përdorët nga opozita për të përshkruar situatën e drogës në Shqipëri gjatë qeverisjes socialiste.

Megadushk: *mega* + *dushk* ← *Dushk* (*Dushk*, emër vendi ku u fituan zgjedhjet në mënyrë të padrejtë dhe krijuan një model që u shndërrua në një problem shumë të madh politik). Në këtë rast parashtesa e parë “mega” është parashtesë e huaj.

Dushkaxhi: *Dushk* + *a* + *xhi* (prapashtesë e gjuhës shqipe), përdorët për parlamentarët dhe politikanët që lidhen me dukurinë politike, për të cilën folëm më lart.

Saligrad: *Sali* (emër) + *grad* (qytet, sllavizëm).

Salalbania: *Sali* (emër) + *Albania* (vend) = Shqipëria e Saliut; Në të njëjtën mënyrë mund të zbërthehen edhe efemerizmat: *Saliala* (shkurtime i *Salalbania*) dhe *Saliburg* (ku në vend të *grad* kemi *burg*).

Berishemi: *Berisha* (*Mbiemri*) + *-emi* (prapashtesë), e përdorur për të përshkruar në mënyrë të caktuar të menduari. Në të njëjtën mënyrë mund të zbërthehen edhe fjalët *berishizim*, *berishizemi*.

¹¹ Nga një Bisedë me analistë në Televizion.

¹² Postim në FB (20 Shkurt, 2015) nga një kundërshtar i E.R.

Ramostan: Ram +o+ stan (stan+ vend, përdoret si prapashtesë e emërimit të vendeve sllave Kirgistan, Uzbekistan), përdoret në mënyrë denigruese për të përshkruar mënyrën e drejtimit të qeverisë;

Ramokracia është formim sipas modelit: autokracia, meritokracia;

“*Sheeptar*” është një formim interesant që tregon mendësi negative për shqiptarët, lidhet me “*sheep*” ang. *dele* (të nënshtruar si *delet*). Kjo fjalë është hibride që formohet nga dy pjesë “*sheep*”- *dele* dhe “*tar*” që është prapashtesa e fjalës *shqiptar*.

Disa fjalë efemere u krijuan nga gazetarët gjatë skandalit të Bankës së Shqipërisë, ku mbiemri i ish Guvernatorit të bankës Fullani u modifikua duke krijuar efemerizmat: *Fullhajni*, *Fullhajni*, *Fullhajneria* etj.

Nofka dhe pseudonime

Edhe pse një ndër mënyrat e spikatura për të shprehur mendësitë e kohës, nofkat në monizëm nuk gjenin terren për t’u përdorur, sidomos në sferën e politikës, me përjashtim të rasteve të rralla të futura nga shkrimtarët e satirës dhe të humorit, të krijuara prej atyre vetë, për të maskuar identitetin e tyre, më tepër në formën e pseudonimeve si: *Khiri-Khiri*, *Hyskë Borobojka* etj. Nga fundi i periudhës së monizmit dhe në fillimet e pluralizmit, nisi të përdorej rrallë ndonjë nofkë në sferën politike si: *Tao Tao* (për kryeministrin e atëhershëm A. Ç.), *Çuni i Lalait* (për Çu En Lain). Po kështu nuk përdorehin as pseudonime në fushën e politikës. Një pjesë e tyre, e ardhur nga Lufta, filluan të zhdukeshin dalëngadalë si *Vjosa* (për M. Sh.), *Besniku* (për H. K.), e ndonjë tjetër, por mbeti në përdorim për një kohë relativisht të gjatë pseudonimi *Komandanti* (për E. Hoxhën).

Në periudhën pluraliste nofkat morën një rol të veçantë për të shprehur mendësitë e reja sidomos në fushën e ligjërimin politik. Mënyra e përshkrimit të një individi në mënyrë të ngjyrosur varet nga faktorë kulturorë, historikë dhe gjeografikë dhe kështu na shfaqen emërtime të tilla si: *Piktori*, *I gjati*, *Naltgjatësia*, *Nastradini*, (nga kundërshtarët politikë për E.R.), *I shkurtëri* (nga kundërshtarët politikë për F. N.), *Doktori*, *Pinoku*, *Babagjyshi* (nga kundërshtarët politikë për S. B.), apo *Thatmir* (nga kundërshtarët politikë për F.M.) etj.

Nofkat kanë një mënyrë shumë dinamike zhvillimi:

- Nofkat mund të vihen mbi bazën e tipareve të ndryshme të objektit/subjektit, nga ana e formës së jashtme, të botës së brendshme, veprimeve etj.
- Sipas fizionomisë së fytyrës: *Pinoku*, *Fytyrgjati*, *Fytyrëngrysur*, *Thatuqi* etj.

- Sipas profesionit, dukurive shoqërore e zanateve: *mjeshtër, specialist*
- Të krijuara sipas mënyrës të së vepruarit: *Kaçi* (Për K. I. i thirrur nga politikanët e majtë me ironi për shkak të kalimit nga PS tek PD).
- Origjinës: *Maloku* (për S. B.), *Labi* (për G.R.), *Skraparliu, Shpellari*¹³ (për I.M.):
- Nofka teriofore (nofka të krijuara nga emrat e kafshëve): erdhi *dhia* (për një politikane nga zonat e thella), *gomari* (gomari s'di të bëjë politikë), *delja* (që është politikan i butë).
- Nofka si emërtime pa konotacion, jonegative, në bazë të profesionit të personalitetit politiko-shoqëror; *Doktori* (S.B), *Piktori* (E.R), *Profesori* (S. Pëllumbi, S. Gjinushi), *Avokati* (S. Ngjela), *Plaku i urtë* (S. Godo) etj.
- Nofka për të ironizuar bazuar në mënyrën e të folurit: “*Thatmir*” (për ish ministrin e Mbrojtjes).

Sinofka

Njësi të afërta me nofkat, që mund të quhen edhe *sinofka* (*kuazinofka*), të krijuara nga bartësit e gjuhës në pluralizëm, si rezultat i lirisë së fjalës, në shumë raste, të përdorura në mënyrë abuzive kryesisht për liderët politikë, drejtuesit e niveleve të ndryshme etj. Si fillesë shërbejnë përdorimet vetëm të emrit (për liderët kryesore), të pëlqyeshme edhe nga ata vetë, për të theksuar lidhjet, afërsinë me publikun, që çojnë më tej në shtrembërime, që marrin formën e sinofkave si: *Sala* (Erdhi *Sala*, dhe jo S. Berisha, apo *Luli* dhe jo L. Basha), që përdoren masivisht edhe nga kategori të ndryshme personash, nxënësit. Po kështu hasim shkurtime e shtrembërime të emrave, për qëllime të ndryshme me theks pozitiv (intimitet) edhe për personalitete të tjera si: *Kaçi, Neri, Sandri, Tosi, Muli, Rami*¹⁴. Më tej, për një varg prej tyre bëhen shtrembërime, shkurtime, kryesisht me vlerë tallëse e humori si: *Sála, Sáli, Lulushi, Lulka, Xhozi* etj.

Sinofkat mund të përdoren për të përshkruar procese si në rastin e *ripjellja*¹⁵, e përdorur në mënyrë sarkastikë dhe vulgare për të përshkruar “rilindjen” socialiste.

Sinofkat mund të jenë togfjalësha: *Saje Qorri*¹⁶ (S. Tahiri), *Mili i partisë, Mili i Partisë Siçiliste* (E. Sh.), *Gjeneral Trafiku, Madamë*

¹³ <http://www.gazetatema.net/web/2011/09/22/eh-sa-e-kishte-pritur-kete-foto-obama-ia-rrenoi-endrren/>

¹⁴ <http://www.gazetatema.net/web/2011/09/22/eh-sa-e-kishte-pritur-kete-foto-obama-ia-rrenoi-endrren/>

¹⁵ S. Berisha, Facebook, 19 Nëntor, 2016.

¹⁶ S. Berisha, Facebook, 23 Nëntor, 2016.

Lokomotiva, Komisari dixhital, Amanita Muskaris (këpurdha superhelmuese etj.), *Maska e Lapsit*¹⁷, *Fantozzi i Parlamentit*¹⁸, *Djaloshi 200 milionësh*¹⁹, *Çunat e krimit*²⁰, *Ekonomia e hashashit*²¹, *Kulla e Ngujimit*²² (Parlamenti).

BIBLIOGRAFI

- Duro, A., *Terminologjia si sistem*, “Panteon”, Tiranë, 2001.
Duro, A., *Togfjalëshat e qëndrueshem terminologjikë në shqipen e sotme*, “Studime Filologjike”, 1982, 2009.
Kostallari, A. (1972), *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, “Studime mbi leksikun dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe”, I, Tiranë.
Lloshi, Xh., *Stilistika e gjuhës shqipe dhe pragmatika*, Tiranë, 2001.
Thomai, J., *Probleme të frazeologjisë së gjuhës shqipe*, SF, 1964/2.
Xhuvani, A. (1980), *Kompozitat*, Vepra, 1, Akademia e Shkencave, Tiranë.

¹⁷ <http://www.panorama.com.al/bushati-i-pergjigjet-berishes-isha-nipi-i-hysni-kapos-serdha-me-valixhe-druri-per-tu-bere-anetar-partie/>

¹⁸ S. Berisha, Facebook, 23 Nëntor, 2016.

¹⁹ LAPSI AL, 23/09/2015.

²⁰ S. Berisha, Facebook, 5 Tetor, 2015.

²¹ I. Yzeiri, “Në vend të hashashit, shkollën”, Gazeta “Shqip”, 7 Shtator, 2015.

²² I. Yzeiri (shih 23).

